

FTESË PËR OFERTË – FAZA E PARË E TENDERIT

Nr. i ref : T-0010-07-2025

Titulli i tenderit: T-0010-07-2025- Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë dhe Ofrimi i shërbimeve për Qendrën e Monitorimit.

Banka ProCredit fton të gjitha kompanitë e interesuara dhe të kualifikuara të paraqesin dokumentacionin e tyre për pjesëmarrje në tenderin e ndarë në dy LOT-e:

- LOT 1 – Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë
- LOT 2 – Ofrimi i shërbimeve për Qendrën e Monitorimit

Gjatë fazës së parë të tenderit, kërkohet dorëzimi i dokumentacionit bazë për vlerësim të përmbushjes së kërkesave të bankës për shërbimet e lartëpërmendura. Vetëm kompanitë që kualifikohen në këtë fazë do të ftohen për **fazën e dytë**, ku banka do të dërgojë dosjen e plotë së bashku me specifikimet teknike.

Në fazën e parë, kompania e interesuar për ofertim duhet të dërgojë dokumentacionet e mëposhtme:

- Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit dhe Informata mbi Biznesin,
- Historiku i Shkurtër i Kompanisë
- Struktura Organizative e Kompanisë
- Licencat përkatëse për operim sipas ligjit në fuqi për Shërbime Private të Sigurisë
- Lista e Kompanive për të cilat ofrohen shërbime/furnizime të ngjashme

Nëse kompania posedon dokumentet e mëposhtme, ju lutemi të dërgohen edhe:

- Certifikata ISO 14001 ose ndonjë standard tjetër ndërkombëtar për praktika të qëndrueshme mjedisore dhe sociale

Palët e interesuara për pjesëmarrje në këtë tender fillimisht duhet të dorëzojnë dokumentet bazë për aplikim sipas kërkesës me lartë, prej datës **05/08/2025** deri më **12/08/2025 në ora 15:00** në e-mail adresën kos.offers@procredit-group.com. Në subjektin e-mailit duhet të shënohet qartë **T-0010-07-2025- Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sigurisë dhe Ofrimi i shërbimeve për Qendrën e Monitorimit**. Gjithashtu, specifikoni qartë nëse aplikoni për **LOT 1, LOT 2**, apo për të dy **LOT-et**.

Vërejtje:

- Banka ProCredit mban të drejtën të kërkojë informata shtesë nga kompanitë e kualifikuara për ofertim.
- Banka ProCredit ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe t'i ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.
- Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të dosjeve nuk kompenzohet.

Çdo pyetje shtesë rreth kësaj ftese për ofertë mund ta adresoni në :

kos.procurement@procredit-group.com